

Më  
Dana

09 - 07 - 2018

REPublika e Kosovës  
REPublika KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2018:008346

Datë: 05.06.2018

Numri i dokumentit: 00053897

P.nr.1974/17

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal**, si gjykatë e shkallës së parë penale, me gjyqtarin Ilir Bytyqi si dhe procesmbajtësen Kadishe Shabani, zyrtare ligjore, në çështjen penale kundër të pandehurit [REDACTED] nga Fsh. [REDACTED], për shkak të veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 1 nënpar. 1.4 të KPRK-së, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj - Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.1914-7/16 dt.11.08.2017, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor publik të mbajtur, në praninë e Prokurorit të Shtetit Albert Zejnullahu si dhe të pandehurit [REDACTED], më datë 07.05.2018 mori dhe publikisht shpalli aktgjykimin, ndërsa me datë 15.05.2018 përpiloi me shkrim këtë:

## AKT GJYKIM

**I pandehuri:** [REDACTED] i lindur me [REDACTED], nga i ati [REDACTED] dhe nëna [REDACTED] e gjinisë [REDACTED] me vendbanim në Fshatin [REDACTED] Komuna Viti, me profesion punëtor, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

## ËSHTË FAJTOR

Me dt. 29.09.2016, rreth orës 21"00, në motelin "Luxor", në Ferizaj, pasi që kanë qëndruar në motel me të dëmtuarën [REDAKTUAR], i pandehuri fillon ta godasë me grushte dhe shuplaka dhe duke ia vendosur këmbën në gjoks i ka thënë se "ta kam marrë inati" me ç'rast të dëmtuarës i ka shkaktuar lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme shëndetësore të përshkruara si në ekspertizën mjeko ligjore të datës 18.07.2017.

**me këtë ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 1 nënpar. 1.4 të KPRK-së.**

Prandaj, gjykata në bazë të neneve 3,4,7,8,17,41,42,46,73 të KPRK-së, si dhe në bazë të neneve 365 të KPPRK-së, e

## G J Y K O N

Dënim me gjobë në lartësi prej 400 Euro /katër qind/, të cilin dënim gjobë obligohet ta paguaj brenda 15 ditëve, pasi aktgjykimi të merr formën e prerë.

Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund ta paguajë dënimin brenda afatit prej 1 /një/ Muaj, pasi aktgjykimi të merr formë të prerë, atëherë gjykata dënimin me gjobë do t'ia zëvendësojë me dënim burgimi ashtu që për çdo 20 Euro /njëzetë euro/, të papaguara do t'i llogaritet 1 (një) ditë burg.

E dëmtuaria [REDAKTUAR] nga Ferizaj, për realizimin e kërkesës pasurore- juridike udhëzohen në kontest civil.

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30 Euro /tridhjetë/ si dhe shpenzimet e procedurës penale për ekspertizë shumë prej 20 Euro /njëzet euro/ në afatin prej 15 ditëve pasi që aktgjykimi të marr formën e prerë nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.

**Detyrohet i akuzuari që për kompensimin e Viktimave të Krimit, të paguaj shumën prej 30 Euro /tridhjetë/, brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.**

### **A r s y e t i m i**

Gjykata pasi studioi materialet e çështjes penale të paraqitur për gjykim, çmoi se çështja është në juridiksionin e saj dhe gjykimi i kësaj çështje penale duhet të realizohet përpara kësaj gjykate. Po kështu është në kompetencën lëndore dhe territoriale të kësaj gjykate, pasi vepra penale për të cilën është proceduar i pandehuri gjykohet nga gjyqtari individual.

PTH në Ferizaj me aktakuzën PP/II.nr.1914-7/16 dt.11.08.2017 ka ngarkuar të akuzuarin [REDAKTUAR], për veprën penale lëndim i lehte trupor nga neni 188 par. 1 të KPRK-së, duke propozuar që i pandehuri të shpallet fajtor dhe ti shqiptohet sanksion penal i paraparë me ligj.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj akuze caktoi dhe mbajti seancën e shqyrtimit fillestar me datë 07.05.2018 në të cilën shqyrtim gjyqësor: *i akuzuari e pranon fajësinë për veprën penale të cilën e ngarkon aktakuza për të gjitha pikat e saj, si dhe shtonë se është i vetëdijshëm për pranimin e fajësisë dhe pasojat që mund të vijnë nga ky pranim, i vjen keq për këtë veprë penale ndihet thellë i penduar, është hera e parë që bie ndesh me ligjin, i premtton gjykatës që në të ardhmen do të kryej vepra penale, dhe në bazë të gjithë këtyre të gjeturave i propozon gjykatës që ti ketë parasysh dhe të i shqipton një dënim më të butë..*

Prokurori i Shtetit Avdullah Abedini duke shprehur mendimin e tij përkitazi me pranimin e fajësisë, ka vlerësuar se ekziston baza për pranimin e fajësisë së të pandehurit, duke i propozuar Gjykatës që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe të i shqipton dënimin e merituar.

Me që i pandehuri ka pranuar fajësinë gjyqtari i vetëm gjykues ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kërkesat e përcaktuara me dispozitën e nenit 248 par.1 të KPPK-së: i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga i pandehuri, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në

materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit, dhe ne provat tjera te cilat gjinden ne shkresën e lendes siç janë: ekspertiza e mjekut ligjor dt.18.07.2017, raporti i oficerit me nr. 2016-CF-2318 i dt.30.09.2016, deklarata e të dëmtuarës e dt.30.09.2016, deklarata e të pandehurit e dt.30.09.2016.

Me qenë se i akuzuari ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, andaj gjyqtari individual konform nenit 248 paragrafit 4 të KPPK-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit, *(nëse i pandehuri në shqyrtimin fillestar pranon fajësinë dhe kryetari i trupit gjykues vlerëson se pranimi i fajit është bërë në pajtim me ligjin mund të vazhdoj procesin me shqiptimin e dënimit pa plotësuar trupin gjykues dhe pa e mbajtur fare shqyrtimin gjyqësor, lidhur me këtë shih mendimin juridik te Gjykatës Supreme të evidentuar si GJA.nr.207/13 të dt.19.03.2013).*

Gjykata pas administrimit/leximit të provave materiale në shqyrtim gjyqësor publik dhe vlerësimit të tyre një nga një dhe në lidhje me provat e tjera, ku në bazë të vlerësimit të tillë vërtetoi këtë gjendje të fakteve si në vijim: me dt. 29.09.2016, rreth orës 21"00, në motelin "Luxor", në Ferizaj, pasi që kanë qëndruar në motel me të dëmtuarën [REDAKTUAR] i pandehuri fillon ta godasë me grushte dhe shuplaka dhe duke ia vendosur këmbën në gjoks i ka thënë se "ta kam marrë inati" me ç'rast të dëmtuarës i ka shkaktuar lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme shëndetësore të përshkruara si në ekspertizën mjeko ligjore të datës 18.07.2017.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 1 nënpar. 1.4 të KPRK-së.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat ne kuptim te nenit 73 dhe 74 të KPRK-së, dhe gjeti si rrethanë lehtësuese se në shqyrtimin fillestar ka pranuar fajësinë, duke e shprehur pendimin e sinqertë dhe real për veprën penale të kryer, i gjendjes së rëndë ekonomike, ndërsa në mungesë të rrethanave veçanërisht rënduese, gjykata vlerësoi shkallen e përgjegjësisë penale të të pandehurit dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale, andaj duke marrë parasysh tërësinë e këtyre rrethanave, të pandehurit i shqiptoi dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindjen se në rastin konkret do të arrihet

Numri i lëndës: 2018:008346

Datë: 05.06.2018

Numri i dokumentit: 00053897

qëllimi i dënimit të preventives speciale dhe asaj gjenerale, ku një dënim i tillë është adekuat dhe në proporcion të drejtë në raport me peshën e veprës penale, rrethanave të kryerjes së veprës penale, shkallen e përgjegjësisë penale dhe personalitetin e të pandehurit.

Vendimi mbi shpenzimet paushalle është marr në kuptim të dispozitës së nenit 450 par. 1 dhe 2 pika 2.6 lidhur me nenin 453 par. 1 të KPPRK-së.

Vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë konform nenit 39 par 3 pika 3.1, Nr. 05/L-036 të ligjit për kompensimin e Viktimave të Krimit.


Vendimi mbi udhëzimin e realizimit të kërkesës pasurore-juridike është marr në kuptim të nenit 463 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së.

Në bazë të së theksuarës më lartë u vendos si në dispozitivit të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**  
**Departamenti Përgjithshëm-Divizioni Penal,**  
**P.nr.1974/17 datë 15.05.2018.**

Zyrtare ligjore,  
Kadisha Shabani

Gjyqtari: Ilir BYTYQI



**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve, pas pranimit të kopjes me shkrim të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.